LIGJ
Nr.7563, datë 11.5.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7503, DATË 26.7.1991 "PER STATUSIN E DEPUTETIT TË KUVENDIT POPULLOR"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si vijon:

"Deputeti i Kuvendit Popullor është funksionar.

Organet e pushtetit lokal administrativ ku është zgjedhur deputeti, janë të detyruara, në fillim të çdo muaji, t'u venë në dispozicion deputetëve planet mujore të punës dhe kalendarin e mbledhjeve, duke përfshirë edhe ndryshimet eventuale që mund t'i bëhen atyre".

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Drejtuesit e shtetit, të Qeverisë, të institucioneve qendrore dhe të organeve të tjera shtetërore ekonomike, detyrohen të presin me përparësi deputetin për problemet që lidhen me detyrën e tij".

Neni 3

Neni 8 hiqet.

Neni 4

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Deputeti ka dokumentin e tij identifikues dhe shenjën dalluese, të cilat përdoren deri në përfundimin e veprimtarisë së Kuvendit Popullor".

Neni 5

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Paga e deputetit të Kuvendit Popullor caktohet me dispozita të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimit për funksionarët e lartë shtetërorë".

Neni 6

Neni 13 ndryshohet si vijon:

"Deputeti me moshë mbi 50 vjeç dhe deputeti me moshë mbi 45 vjeç, që kanë qenë të zgjedhur për 12 vjet në punë parlamentare në Kuvendin Popullor pluralist, gëzojnë të drejtën e pensionit të pleqërisë. Llogaritja e pensionit bëhet mbi bazën e pagës që ka marrë si deputet.

Deputetit që mbetet pa punë pas shpërndarjes së Kuvendit Popullor, i sigurohet menjëherë punë sipas profesionit dhe në vendbanimin e tij. Deri në fillimin e punës, atij i jepet paga e deputetit".

Neni 7

Neni 14 ndryshohet si vijon:

"Deputeti që nuk banon në qytetin e Tiranës, përfiton dietë ditore gjatë kohës që merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit Popullor, të komisioneve të tij dhe të grupit parlamentar.

Deputeti përfiton pagë ditore edhe kur shkon jashtë rrethit për të marrë takim me zgjedhësit e zonës së tij ose dërgohet me shërbim nga Kuvendi Popullor.

Dieta e deputetit caktohet në masën 4 për qind të pagës së tij mujore.

Neni 8

Pas nenit 14 shtohet neni 14/a me këtë përmbajtje:

"Për sigurimin e kushteve të punës dhe të banimit për deputetët e Kuvendit Popullor, të krijohet Shtëpia Parlamentare".

Neni 9

Neni 15 ndryshohet si vijon:

"Deputeti, kur dërgohet me shërbim jashtë shtetit përfiton dietë ditore të caktuar me dispozita të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimit për funksionarët e lartë shtetërorë".

Neni 10

Neni 18 ndryshohet si vijon:

"Deputeti ka të drejtën e lejes së pagueshme vjetore prej 30 ditësh, e cila merret vetëm pas ndërprerjes së punimeve të Kuvendit Popullor".

Neni 11

Në paragrafin e dytë të nenit 19 hiqen fjalët "ose me anë të personave të tretë".

Neni 12

Në nenin 20, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Qeveria është e detyruar të sigurojë pa pagesë udhëtimet e deputetit nga rrethi në Tiranë dhe anasjelltas, si dhe ato brenda e jashtë rrethit që lidhen me kryerjen e detyrës së tij".

Neni 13

Neni 22 ndryshohet si vijon:

"Deputeti pajiset me numër telefoni.

Shpenzimet për bisedat e tij telefonike brenda vendit përballohen nga shteti".

Neni 14

Në nenin 23, në vend të fjalës "rrethit" vihen fjalët "njësisë administrative tokësore".

Neni 15

Në paragrafin e parë të nenit 24, në vend të fjalëve "në rrethin" vihen fjalët "që përfshihen në zonën".

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.181, datë 16.5.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.